

VENDIM
Nr. 29, datë 3.2.2025

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “MER ENERGJI” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

(Ndryshuar me vendimin nr. 240, datë 30.9.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.2.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 52/5 prot., datë 30.1.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “MER Energji” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “MER Energji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2410 prot., datë 18.11.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Faqekuq 3”, me kapacitet të instaluar 1300 kW, me vendndodhje në fshatin Vlush, Njësia Administrative Leshnjë, Bashkia Skrapar, qarku Berat.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 258, datë 2.12.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 3.12.2024 dhe 4.12.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 12.12.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 2410/3 prot., datë 5.12.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, duke i kërkuar gjithashtu që të shprehet nëse ka një qëndrim ndryshe mbi vlefshmërinë e kontratave të depozituara në kuadër të këtij aplikimi, si dhe mbi të drejtën e shoqërisë “MER Energji” sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Deri në këtë vendimarrje, MIE nuk ka dhënë një përgjigje.

- Me shkresën nr. 2410/4 prot., datë 5.12.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës, si dhe i ka kërkuar që të dorëzojë në ERE informacionin ose dokumentacionin e aplikimit që është konstatuar si i munguar ose i paraqitur në format të papërshtatshëm (fotokopje).

- Me qëllim shqyrtimin e dokumentacionit plotësues të depozituar nga shoqëria, të protokolluar në ERE me nr. 2410/5 prot., datë 24.12.2024 dhe/ose zhvillimin e një korrespondence të mundshme në vijim, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 7, datë 6.1.2025, u vendos zgjatja e afatit të vendimarrjes deri në 30 (tridhjetë) ditë.

- Me shkresën nr. 52 prot., datë 9.1.2025, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e sipërcituar, dhe duke e informuar mbi dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e aplikimit.

- Shoqëria nëpërmjet shkresës nr. 52/1 prot., datë 15.1.2025, ka depozituar në ERE dokumentacionin/informacion plotësues. Pas shqyrtimit të tij, u konstatua se ende mungonte dokumentacioni i depozituar në formën e kërkuar, pasi disa dokumente ishin paraqitur në format fotokopje. Në vijim të korrespondencës me ERE-n, shoqëria ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar

në formën e duhur, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 52/2 prot., datë 28.1.2025 dhe nr. 52/4 prot., datë 30.1.2025.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”; si dhe për pikën 2.1 germat “a”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “MER Energji” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me MIE, kontratën e koncesionit të formës BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) “Për ndërtimin e hidrocentralit ‘Faqekuq III’ nr. 2183 rep., nr. 1145/3 kol., datë 16.10.2018, ndryshuar me kontratën shtesë nr. 15 rep., nr. 9 kol., datë 7.10.2022 dhe kontratën shtesë nr. 962 rep., nr. 299 kol., datë 26.6.2023;

- Ka depozituar shkresën e shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. me nr. 216/3 prot., datë 12.1.2022, për miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes;

- Ka depozituar në ERE, vendimin nr. 2, datë 3.10.2022, “Për miratimin e lejes ‘Për përdorim të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë ‘MER Energji’ sh.p.k.’”, të Këshillit të Basenit Ujqor Seman, si dhe lejen për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor nr. 746 prot., datë 10.10.2022, e lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujqor (KBU) Seman. Vlefshmëria e kësaj lejeje është sipas kontratës së koncesionit.

- Ka depozituar vendim për VNM paraprake, lëshuar më datë 24.3.2022, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i HEC Faqekuq 3, me fuqi të instaluar 1300 kW dhe ka dokumentuar fillimin e zbatimit në terren të projektit brenda afatit të kësaj VNM-je.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Po ashtu, në nenin 5, pika 2 të rregullores së sipërcituar, parashikohet se për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE më vonë se data efektive e kontratës/autorizimit, llogaritja e afatit së licencimit, bëhet për periudhën e mbetur.

- Kontrata e koncesionit nr. 2183 rep., nr. 1145/1 kol., datë 16.10.2018, e ndryshuar, ka një afat 35-vjeçar dhe konstatohet se shoqëria ka humbur afërsisht 6 vjet e 3 muaj nga periudha koncensionare. Si rezultat, periudha e mbetur për licencim është afërsisht 28 vjet e 8 muaj, afat i cili përfundon më datë 16.10.2053, ndaj dhe licenca do të jetë e vlefshme deri në këtë datë.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës nr. 2183 rep., nr. 1145/1 kol., datë 16.10.2018, të ndryshuar me kontratën nr. 962 rep., nr. 299 kol., datë 26.6.2023, dhe të dokumentacionit të depozituar në ERE në kuadër të këtij aplikimi, rezulton se shoqëria duhet të vendosë në operim hidrocentralin brenda datës 14.5.2025. Po ashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 11 “Testimi i veprës” të kësaj kontrate, vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që me fillimin e operimit/ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “MER Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Faqekuq 3”, me kapacitet të instaluar 1300 kW, me vendndodhje në fshatin Vlush, Njësia Administrative Leshnjë, Bashkia Skrapar, qarku Berat, me afat deri më 16.10.2053.

2. *Shfuqizuar.*

3. *Shfuqizuar.*

4. *Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.*

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “MER Energji” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSSH sh.a., FTL sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti